

## **Informacion per faqen e internetit te Ministrise mbi projektet me financim nga donatorë të huaj dhe bashkëfinancim nga Qeveria Shqiptare.**

**Titulli i projektit:**    **Forcimi i kapaciteteve të MM për hartimin e ligjeve dhe zbatimin e legjislacionit kombëtar të Mjedisit- SELEA.**  
Financuesi:                Bashkimi Evropian IPA 2010.  
Kosto totale:             4,4 milion Euro  
Kohëzgjatja:             Janari 2012 – Korrik 2014

**Objektivi** i pergjithshem i projektit është të mbështesë MM në rritjen e kapaciteteve të saj për të bërë të mundur zbatimin dhe forcimin e legjislacionit mjedisor.

Objektivi specifik i projektit ka te beje me sigurimin e kushteve më të mira përmes përmirësimit të menaxhimit mjedisor duke bërë të mundur që institucionet shtetërore të zbatojnë legjislacionin mjedisor në përputhje me standartet e BE-së.

### **Projekti ka tre komponentë si më poshtë:**

- Komponenti A: Rritja e aftesisë së stafit të MM-së për forcimin e zbatimit të legjislacionit mjedisor.
- Komponenti B: Përmirësimi i inspektimit, ndjekja dhe zbatimi i legjislacioni mjedisor.
- Komponenti C: Përmirësimi i menaxhimit mjedisor nga Agjensia e Mjedisit në nivel kombëtar dhe rajonal.

### **Aktivitetet e projektit jane si më poshtë;**

1. Hartimi i planeve rajonale te Menaxhimit të Mbetjeve
2. Hartimi i planeve menaxhuese për Zonat e Mbrojtura
3. Hartimi i Strategjise se Mjedisit për Cilësinë e Ajrit në Shqipëri
4. Pergatitja e disa drafteve të ndryshme ligjore dhe akteve nenligjore
5. Programe Trajnimi per Inspektoriatin Qendror.
6. Ture studimore si dhe trajnime për stafin e Ministrisë.

**Titulli i projektit:** Drejt qeverisjes se sforcuar te trashegemise se perbashket natyrore dhe kulturore nderkufitare te rajonit te liqenit te Ohrit

Financuesi: Bashkimi Evropian

Kosto totale: 1,7 milion Euro

Kohezgjatja: 2014-2017

**Objektivi** i projektit është: të përforcojë strukturat e menaxhimit të rajonit ndërkufitar të liqenit të Ohrit në funksion të një njohje të mundshme të gjithë zonës kulturore dhe natyrore të Liqenit, si pronë të Trashëgimisë Botërore.

**Projekti ka tre komponentë si më poshtë:**

- (i) Forcimin e platformës se bashkëpunimi ndërkufitar për Liqenin e Ohrit dhe rritjen e mundësive për turizëm;
- (ii) Zbatimin e fushatës për mbetjet përmes aktiviteteve pilot;
- (iii) Njohjen e procesit për të gjithë zonën e Liqenit si pronë e Trashëgimisë Botërore

**Titulli i projektit:** Ndertimi i Portit te Peshkimit Durrës  
Financuesi: Banka Islamike  
Kosto totale: 21.8 Mln USD.  
Kohezgjatja: 2008 – 2014.

**Objektivi** kryesor i projektit është ndertimi dhe ripozicionimi i portit te peshkimit, i nje korridori transporti te sigurt, te vazhdueshem, eficient dhe konform standarteve te projektimit European dhe Nderkombetar. Synimi kryesor eshte largimi i gjithe pengesave qe ndikojne ne rrjedhshmerine e trafikut pergjate rruges. Kjo nenkupton porte modern, te mirepajisur dhe qe mund te trajtoj me efikasitet gjithe llojet e ngarkesave duke perfshire dhe trafikun e konteinereve.

**Aktivitetet kryesore te projektit jane:**

1. Ndertimi i mjediseve te portit, ku perfshihen ndertimi i rruges kryesore ne port, bonifikimi i tokes ne qender te pengeses dallgepritese, ndertimi i bankines, i tre pontilave ancoruespengesave dallgepritese, etj.
2. Sherbime konsulence.

**Titulli i Projektit:   Projekti i Përmirësimit të Administrimit të Burimeve Natyrore**

Financuesi:               SIDA, menaxhohet nga Banka Botërore.

Kosto totale:           2.716 MI USD.

Kohezgjatja:           Nentor 2012 – Qershor 2014.

**Objektivi** i projektit është dhënia e mbështetjes së vazhdueshme për të përmirësuar administrimin e burimeve natyrore në zonat e larta dhe malore me baza komunitetin, me predispozite erozioni në Shqipëri.

**Komponentet e projektit janë:**

1. Mbështetje për përkrahjen dhe përgatitjen e planeve të administrimit për kullotat dhe pyjet dhe planeve të mikrobasenave ujëmbledhëse;
2. Zbatimin e skemave pilote të granteve konkurruese për administrimin e mikrobasenave ujëmbledhëse për të mbështetur zonat agromjedisore
3. Kryerja e punimeve dhe investimet në kullota për 21 Komuna
4. Mbjellja e sipërfaqeve për të ndihmuar në procesin e sekuestrimit të karbonit.

**Titulli i Projektit: Parku Biosferik Ndërkufitar i Prespës – Mbështetje PK Prespa Shqipëri**

Financuesi: Qeveria Gjermane, Banka KfW

Kosto totale: 3,830.000 MI Euro

Kohezgjatja: 2011 - 2015

**Objektivi** kryesor i këtij projekti është të kontribuojë në mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit në kontekstin ndërkufitar të tre shteteve (Shqipëri, Greqi, Maqedoni) me pjesëmarrjen e të gjithë të interesuarve.

**Komponentet e projektit janë:**

1. Menaxhimin e masave mbrojtëse si dhe forcimin e kapaciteteve të administratës së parkut
2. Menaxhimin e Qëndrueshëm të Pyjeve dhe Kullotave
3. Rritjen e ndërgjegjësimit dhe përfshirjen e komunitetit
4. Integrimi në Konceptin e Biosferës dhe koordinimi me programet e tjera në rajonin e përfshirë.

**Titulli i projektit:** Transformimi i tregut dhe fuqizimi i iniciativës për përdorimin e paneleve diellore për ujë të ngrohtë në Shqipëri”.

Financuesi: GEF/UNDP/ METE/ MM.

Kosto totale: 2,105,000 USD;

Kohëzgjatja: 2010 -2015.

**Objektivi** kryesor i këtij projekti është përkrahja dhe miratimi i energjisë diellore si një nga burimet më të fuqishme të energjive të rinovueshme në Shqipëri, nëpërmjet mënjanimit të pengesave dhe reduktimit të kostos së zbatimit.

**Aktivitetet kryesore të projektit janë:**

- Krijimi i një kuadri ligjor, rregullator dhe institucional për të promovuar një treg të qendrueshëm për panele diellore për ujë të ngrohtë (**Solar Water Heating/SWH**)
- Rritja e ndërgjegjesimit dhe e kapaciteteve të përdoruesve fundor dhe furnizuesve për SWH
- Rritje e kërkesës për SWH përmes aplikimit të një mekanizmit të pershtatshëm financiar dhe modele të tjera të tilla si SESCO.
- Aplikimi i një skeme të pershtatshme për Shqipërinë për certifikimin dhe kontrollin e paneleve diellore SWH dhe rritja e ndërgjegjesimit të furnizuesve të këtyre sistemeve me qëllim promovimin e një tregu të qendrueshëm të SWH

**Titulli i projektit:** Përmirësimi i mbulimit dhe efikasitetit të menaxhimit të zonave të mbrojtura detare dhe bregdetare

Financuesi: GEF/UNDP.  
Kosto totale: 2,927,500 USD;  
Kohëzgjatja: 2011 - 2015.

**Objektivi** kryesor i këtij projekti është të përmirësojë efektivitetin e mbulimit dhe menaxhimit të rrjetit të Shqipërisë për zonat e mbrojtura detare dhe bregdetare, si një aspekt plotësues thelbësor për rrjetin e zonave të mbrojtura tokësore.

**Komponentet e projektit janë:**

- Përmirësimi i përfaqësimit bio-gjeografik i Zonave të Mbrojtura Detare dhe Bregdetare (ZMDB), dhe
- Përmirësimi i menaxhimit të ZMDB duke qartësuar kuadrin institucional si dhe ngritjen e kapaciteteve.

**Aktivitetet e projektit janë:**

- 1 Hartimi i Strategjise se Planit te Veprimit për Zonat e Mbrojtura Detare (PSZMDBS); e cila është pjesë e Strategjisë së përditësuar të Biodiversitetit
- 2 Fushatat e informimit, komunikimit dhe ndërgjegjësimit për rëndësinë e vlerave dhe nevojave për mbrojtjen e ZMDB në Shqipëri.

**Titulli i projektit: Komunikimi i tretë Kombëtar**

Financuesi: GEF  
Kosto totale: 480, 000 USD  
Kohezgjatja: 2012 – 2015.

**Objektivi** kryesor i projektit është përditësimi vjetor i Inventarit të Gazeve serë antropogjene për periudhën 2000 -2005, e cila do të përdoret për të zhvilluar një Strategji kombëtare për uljen e karbonit.

**Projekti ka pesë komponentë:**

1. Vlerësimin e rrethanave kombëtare dhe masat e marra për të zbatuar KKKBNK në Shqipëri;
2. Inventarin kombëtar për gazet serë për periudhën 2000 -2005;
3. Ndryshimet klimatike dhe vlerësimi i prekshmërisë;
4. Analizat për zbutjen e gazeve serë;
5. Publikimin dhe pormovimin i Komunikimit të tretë kombëtar të përgatitur.



**Titulli i Projektit: Rishikimi i Strategjisë Kombëtare të Biodiversitetit**

Financuesi: UNEP/GEF

Kosto totale: 275. 000 \$

**Objektivi** kryesor i ketij projekti eshte rishikimi i dokumentit te Strategjise dhe planit te veprimit per biodiversitetin per periudhen deri ne vitin 2020, si dhe hartimi i raportit te peste kombetar te Shqiperise per zbatimin e konventes.

**Aktivitet kryesore te projektit jane:**

1. Hartimi i raportit te situates aktuale.
2. Pergatitja e draft strategjise dhe planit te veprimit te kostuar;
3. Pergatitja e raportit te monitorimit te strategjise;
4. Hartimi i raportit te peste kombetar te Shqiperise per zbatimin e Konventes.

**Titulli i projektit: Ndërtimi i kapaciteteve për zbatimin e kuadrit kombëtar për Biosigurinë në Shqipëri**

Financuesi: UNEP/ GEF  
Kosto totale: 863,800 USD  
Kohëzgjatja: 2011 -2015.

**Objektivi** kryesor i këtij është të kompletojë zhvillimin dhe përgatitjen për zbatim të Kuadrit Kombëtar për Biosigurinë, në linjë me prioritetet kombëtare dhe detyrimet e Protokollit të Kartagenës për Biosigurinë.

**Aktiviteti kryesorë të projektit janë:**

1. Përgatitjen e legjislacionit sekondar;
2. Caktimin e Autoritetit Kompetent Kombëtar për OMGJ-të dhe të Këshillit Kombëtar të Biosigurisë;
3. Ngritjen e laboratorit për OMGJ-të si dhe ndihmesën për pajisjen dhe çertifikimin e tij;
4. Vendosjen e mekanizmit për monitorimin sektorial;
5. Ndërgjegjësimin e publikut nëpërmjet zhvillimit të workshopeve trajnuese dhe sensibilizuese;
6. Aktivitete që do të mundësojnë përmirësimin e pjesëmarrjes së publikut në vendim-marrjen për biosigurinë.

**Titulli i projektit:      **Projekti i Ozonit, Forcimi Institucional****

Financuesi:                **UNEP/UNIDO.**

Kosto totale:             **109.400 USD;**

Kohëzgjatja;            **2011 -2014.**

**Objektivi** kryesor i këtij projekti është forcimi i kapaciteteve kombëtare me synimin lehtësimin e koordinimit efektiv të administrimit të problemeve të Ozonit.

**Aktivitetet kryesor te projektit jane:**

1. Forcimi Institucional i cili mbështetet ne Marreveshjen ndermjet UNEP-it dhe Ministrise se Mjedisit.
2. Trajnimi dhe ndërgjegjësimi per te forcuar bashkëpunimin me doganat.
3. Përmirësimi i legjislacionit, lidhur me liçensimin dhe çertifikimin e teknikeve te ftohjes.

**Titulli i Projektit: Mbrojtja dhe përmirësimi i menaxhimit të integruar të mjedisit detar dhe ndërkufitar të burimeve natyrore - ECOSEA”.**

Fiancuesi: Bashkimi Evropian- IPA Adriatic  
Kosto totale projekti: 3.757.555,00 €  
Kosto totale- Shqiperia: 250.470,00 €.  
Kohezgjatja: 2012 - 2015.

**Objektivi** kryesor i projektit është të promovojë përmirësimin e ekosistemeve detare dhe bregdetare duke propozuar modele për një menaxhim të koordinuar të peshkimit, me aktivitete direkte për të përmirësuar qëndrueshmërinë e peshkimit dhe forcimin e biodiversitetit detar. Ky projekt ka 9 partnerë, respektivisht 6 rajone italiane, 2 kroate dhe Ministrine e Mjedisit

Ndërkohë, ne kuader te aktiviteteve te projektit, çdo partner punon për Paketën e Punës, për të cilën janë lider për detajimin e planit të aktiviteteve. Ministria e Mjedisit e Shqipërisë është lider për paketën e punës për: (I) Forcimin e ekosistemeve dhe biodiversitetit të detit Adriatik;

**Titulli i projektit: Reduktimi i Karbonit në Europën Jug-Lindore - LOCSEE.**

Fiancuesi: Bashkimi Evropian-IPA me shumë përfitues.  
Kosto totale projekti: 56,507.86 Euro,  
Kosto totale- Shqiperia: 9,971.97 Euro  
Kohezgjatja: Tetor 2012 – Shtator 2014

**Objektivi** kryesor i projektit është forcimi i kapaciteteve në vendet e Europës Juglindore lidhur me hartimin e strategjive me karbon të ulët, në linjë kjo me kërkesat e pritshme të anëtarësimit në BE, duke krijuar një rrjet të shkëmbimit të informacionit, metodologjive, eksperiencave dhe praktikave më të mira në nivel kombëtar dhe rajonal.

Pjese e ketij projekti jane vendet anetare te Bashkimit European: Austria, Belgjika, Greqia, Hungaria, Italia dhe Sllovenia si edhe vendet jo anetare te BE: Shqiperia, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia.

Projekti do te zhvillohet duke u bazuar ne 6 paketa pune perkatesisht:

1. Menaxhimi financiar
2. Aktivitetet komunikuese
3. Analiza mbi gjendjen aktuale dhe platforma e praktikave me te mira.
4. Transpozimi i koordinuar ne legjislacionin kombetar i legjislacionit të BE-se per fushen e Ndryshimeve klimatike.
5. Rritje kapacitetesh per zhvillimin e politikave me karbon te ulet.
6. Zhvillimi i dokumentiti politik me karbon te ulet.

**Titulli i projektit:** **Konservimi dhe Përdorimi i Qëndrueshëm i Parkut Kombëtar Divjakë -Karavasta, me pjesëmarrjen e Pushtetit Lokal dhe aktorëve të tjerë**

Financuesi: JICA;  
Kosto totale: 1 Mln Euro.  
Kohezgjatja: 2012 – 2014.

**Objektivi** kryesor i projektit është krijimi i nje sistemi për konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të Parkut Kombëtar Divjakë – Karavasta, bazuar në një plan menaxhimi, me pjesmarrës aktiv qeverisjen vendore dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm.

**Aktivitetet kryesore te projektit jane:**

1. Hartimi i planit te menaxhimit per Parkun Kombetar Divjake – Karavasta
2. Hartimi i planit te veprimit te Parkut
3. Trajnimi i stafit te parqeve Kombetare te Shqiperise
4. Fuqizimi me pajisje logjistike per stafin e Parkut Divjake – Karavasta
5. Zbatimi i disa aktiviteteve pilote si:
  - Krijimi i nje harte te burimeve lokale turistike
  - Monitorimi i gjithe llojeve te shpendeve
  - Edukimi mjedisor i nxenesve te shkollave
  - Prezantimi i skemave te bujqesise organike ne Parkun Kombetar

**Titulli i projektit: Rezervat Ujore dhe Ujitja**

Fiancuesi: Banka Boterore;  
Kosto totale: 4,675,000 \$.  
Kohezgjatja: 2013 – 2018.

**Objektivi** kryesor i ketij projekti eshte qe te percaktoje kuadrin strategjik per menaxhimin e burimeve ujore ne nivelin kombetar dhe ne nivelin e baseneve te Lumit Drin – Buna dhe Seman. Gjithashtu do te permiresoje ne menyre te qendrushme, performancen e Sistemeve te Perzgjedhura te Ujitjes.

**Aktivitetet kryesore te projektit jane:**

1. Hartimi i Strategjise Kombetare te burimeve ujore dhe ujitjes.
2. Ngritja e Kadastres ujore dhe Planit te Menaxhimit te baseneve ujembledhese.

**Titulli i projektit:**    **Ruajtja dhe Perdorimi i Qendrushem i Biodiversitetit ne  
Liqenet e Prespes, Ohrit dhe Shkodres (Plan Rajonal per Shqiperine  
Maqedonine dhe Malin e Zi)**

Financuesi:                GIZ Gjerman;  
Kosto totale:             2 Mln Euro.  
Kohezgjatja:             2012 – 2014.

**Objektivi i pergjithshem eshte:** Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit, rregulloreve dhe planeve të menaxhimit për konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit në liqenet e Prespës, Ohrit dhe Shkodrës.

**Projekti do te perfshije 4 komponente:**

1. Monitorimi i faunës dhe florës në përputhje me Direktivën e BE-së mbi Habitatet (Natura 2000)
2. Menaxhimi i peshqve dhe peshkimit, duke përfshirë përcaktimin e kuotave
3. Mbrojtja dhe rehabilitimi i ligatinave
4. Karakteristikat e liqeneve dhe përcaktimi i objektivave mjedisore sipas Direktivës Kuadër të Ujit të BE-së



**Titulli i projektit: Ruajtja dhe Perdorimi i Biodiversitetit ne zonat rurale ne Shqiperi**

Financuesi: GIZ Gjerman;  
Kosto totale: 2 Mln Euro.  
Kohezgjatja: 2012 – 2015.

**Objektivi i pergjithshem eshte:** Permiresimi dhe zbatimi i koncepteve per ruajtjen dhe perdorimin e qendrueshem te biodiversitetit, duke perfshire agro-diversitetin, ne Alpet shqiptare".

**Projekti do te synoje keto aktivite:**

- Zbatimin e Strategjise Kombetare te Biodiversitetit dhe Planit te Veprimit, si dhe strategjive e planeve te tjera kombetare per biodiversitetin dhe zhvillimin rural.
- Ngritjen e nje sistemi monitorimi te biodiversitetit.
- Permiresimin e menaxhimit te zonave te mbrojtura.
- Krijimi e nje sistemi te zonave te mbrojtura ne Alpet shqiptare dhe nje sistemi menaxhimi te ketyre zonave.
- Zhvillimi i strategjive per perdorimin e qendrueshem te biodiversitetit.
- Nxitjen e sistemeve te prodhimit bujqesor qe jane miqesore me biodiversitetin dhe zhvillimin e qendrueshem te pyjeve.
- Zhvillimin e qendrueshem te agro-diversitetit.
- Zhvillimin e eko-standardeve per produktet bujqesore dhe pyjore.
- Zhvillimin e zinxhirit te vlerave per produkteve bujqesore miqesore me biodiversitetin, te bimëve të egra (mjeksore), prodhimeve drunore dhe jo drunore në mënyrë që të përmirësohen të ardhurat e popullatës lokale, në mënyrë të qëndrueshme.

**Titulli i projektit: Ruajtja dhe Perdorimi i Biodiversitetit ne zonat rurale ne Shqiperi**

Financuesi: GIZ Gjerman;

Kosto totale: 2 Mln Euro.

Kohezgjatja: 2012 – 2015.

**Objektivi i pergjithshem eshte:** Permiresimi dhe zbatimi i koncepteve per ruajtjen dhe perdorimin e qendrueshem te biodiversitetit, duke perfshire agro-diversitetin, ne Alpet shqiptare".

**Projekti do te synoje keto aktivite:**

- Zbatimin e Strategjise Kombetare te Biodiversitetit dhe Planit te Veprimit, si dhe strategjive e planeve te tjera kombetare per biodiversitetin dhe zhvillimin rural.
- Ngritjen e nje sistemi monitorimi te biodiversitetit.
- Permiresimin e menaxhimit te zonave te mbrojtura.
- Krijimi e nje sistemi te zonave te mbrojtura ne Alpet shqiptare dhe nje sistemi menaxhimi te ketyre zonave.
- Zhvillimi i strategjive per perdorimin e qendrueshem te biodiversitetit.
- Nxitjen e sistemeve te prodhimit bujqesor qe jane miqesore me biodiversitetin dhe zhvillimin e qendrueshem te pyjeve.
- Zhvillimin e qendrueshem te agro-diversitetit.
- Zhvillimin e eko-standardeve per produktet bujqesore dhe pyjore.
- Zhvillimin e zinxhirit te vlerave per produkteve bujqesore miqesore me biodiversitetin, te bimëve të egra (mjeksore), prodhimeve drunore dhe jo drunore në mënyrë që të përmirësohen të ardhurat e popullatës lokale, në mënyrë të qëndrueshme.